
 <b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosovo</b>	<b>ZYRA E PERSONELIT</b> <b>KANCELARIJA OSOBLJA</b>		 <b>Komuna e Istogut</b> <b>Opština Istok</b>
	<b>02 Nr.194 /18</b>	<b>Data:</b> <b>03.10.2018</b>	

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. Dhe 2. të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, Komuna e Istogut ,shpall:

### K o n k u r s

#### Për kryerjen e punëve me kontratë për kohë të caktuar

Vendi i punës: Pastruese në Shtëpinë e Kulturës  
 Institucioni : Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport  
 Numri i Ekzekutuesve: 1 (një )  
 Numri i referencës:02Nr. 194 /18  
 Paga mujore: 250 € në muaj  
 Kohëzgjatja e Emrimit : Me afat të caktuar - 1 ( një ) vit  
 Orari i plotë : 40 orë në javë

**Detyrat :**

- Të kujdeset për pastrimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës
- T'i përgjigjet çdo ftese sipas nevojës të porositësit të shërbimeve për punë sipas nevojës në objektin e shtëpisë kulturës
- Të njoftojë me kohë porositësin e shërbimeve për mungesën e paisjeve dhe materialit higjieno-sanitarë ;
- Si dhe shërbimet të tjera që rrjedhin nga natyra e punës së pastrueses të kërkuara nga mbikëqyrësi.

**Kushtet për punësim :**

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Të mos jetë i ndjekur penalisht

**Dokumentacioni i nevojshëm;**

- Kopja e dokumentacionit të kualifikimit(diploma e shkollës së mesme),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikata e lindjes apo ekstrakti i lindjes,
- Dy rekomandime,
- Dëshmi qe nuk jeni i ndjekur penalisht.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

Afati i aplikimit: Konkursi është i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 03.10.2018 deri më datë 17.10.2018

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.



Menaxheri i Peronelit

Fatmir Bytyçi